

KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

STATUTI

I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Shkup, Mars 2017

PËRMBAJTJA

PREAMBULA	3
KAPITULLI I: DISPOZITAT E PËRGJITSHME	5
KAPITULLI II: QELLIMET DHE DETYRIMET	6
KAPITULLI III: VULLNETARIZMI DHE ANATRESIA	9
KAPITULLI IV: STRUKTURA ORGANIZATIVE	12
UDHËHEQJA	12
KUVENDI	13
KËSHILLI UDHËHEQËS	16
KRYETARI	19
NËNKRYETARI	20
KOMISIONI FINANCIAR	21
KOMISIONET	22
TRUPAT KËSHILLËDHËNËSE	23
TË RINJTË E KRYQIT TË KUQ	24
KAPITULLI V: SEKRETARI I PERGJITHSHEM	24
ADMINISTRIMI	24
SHËRBIMI PROFESIONAL	26
KAPITULLI VI: ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË .27	
ZYRA QENDRORE E KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	27
KRYQI I KUQ I QYTETIT TË SHKUPIT	28
ORGANIZATAT KOMUNALE	29
ORGANIZATAT THEMELORE	31
KAPITULLI VII: SHËRBIMI PËR KËRKESA: RIVENDOSJA E LIDHJEVE FAMILJARE	32
KAPITULLI VIII BASHKËPUNIMI	33
KAPITULLI IX: TRANSPARENCA NË PUNË	33
KAPITULLI X: DHËNIA E MIRËNJOHJEVE	34
KAPITULLI XI: FINANCIM I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	34
KAPITULLI XII: NDËRPRERJA E PUNËS SË KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	39
KAPITULLI XIII: DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	39

PREAMBULA

Iniciativa për formimin e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë është paraqitur në Mbledhjen II të KAÇKM (ASNOM-it) në vitin 1944, kurse është themeluar më 17 mars të vitit 1945.

Vepron dhe punon në mënyrë të pavarur si Shoqatë nacionale që nga 21 maji i vitit 1992.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 25 gusht të vitit 1993 i nënshkroi Konventat e Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949 dhe Protokollet Shtesë të vitit 1977, ndërsa Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më 01 gusht të vitit 2008 ratifikoi Protokollin e Tretë Shtesë të vitit 2005.

Më 26 korrik të vitit 1994 në mbledhjen e Kuvendit të RM-së u miratua Ligji i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë me të cilin organizata e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë u njoh si e vetmja organizatë e Kryqit të kuq në territorin e RM-së për të ndihmuar popullatën e rrezikuar dhe për të mbështetur institucionet shtetërore në planin humanitar

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është njohur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq më 01 nëntor të vitit 1995 dhe është anëtare e plotfuqishme e Federatës së shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhëna e Kuqe nga 27 nëntori i vitit 1995.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në punën e tij udhëhiqet nga parimet themelore të lëvizjes, Statutit të Lëvizjes ndërkombëtare – Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe, Konventat e Gjenevës të vitit 1949, Protokollet Shtesë të vitit 1977 dhe 2005, rezolutat e Konferencës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe dhe Këshillit të Delegatëve, Ligji i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë nga viti 1994, Statuti i Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe dhe Statuti i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Lëvizja ndërkombëtare përbëhet nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq, Federatës ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe dhe Shoqatave nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe.

Parimet themelore të Lëvizjes:

- **Humanizmi** - Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe u krijuan si rezultat i dëshirës për të ndihmuar të plagosurit në fushëbeteje pa asnjë anshmëri, si dhe për të parandaluar dhe lehtësuar vuajtjet njerëzore në rastet kur është e mundur . Qëllimi i Lëvizjes është të mbrojë jetën dhe shëndetin si dhe të respektojë njeriun. Promovon mirëkuptim të ndërsjellët, miqësi, bashkëpunim dhe paqe të përhershme mes të gjithë popujve.
- **Paanshmëria** - Nuk bën diskriminim në baza nacionale, racore, fetare dhe të përkatësisë klasore apo bindjes politike. Përpiqet për të lehtësuar vuajtjet e individëve, duke u nisur vetëm nga nevojat e tyre, dhe duke u dhënë përparsi rasteve më urgjente.
- **Neutraliteti** - Për të gëzuar besimin e të gjithëve, lëvizja nuk duhet të pozicionohet dhe të mbajë anë të natyrës politike, racore, fetare apo ideologjike.
- **Pavarësia** - Lëvizja është e pavarur. Shoqatat nacionale edhe pse kryejnë rol ndihmës në shërbimet humanitare të qeverive dhe janë lëndë e rregullimit të legjislacionit nacional, duhet ta ruajnë autonominë në mënyrë që të mund të veprojnë në çdo kohë, në përputhje me parimet e Lëvizjes.
- **Shërbimi vullnetar** - Kjo është lëvizje për dhënien e ndihmës vullnetare që nuk është e frymëzuar nga motivet materiale.
- **Uniteti** - Në një shtet mund të ketë vetëm një Shoqatë nacionale të Kryqit të kuq apo Gjysmëhënës së kuqe. Duhet të jetë e hapur për të gjithë dhe të kryejë punën e saj humanitare në gjithë territorin e vendit.
- **Universaliteti** - Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, të gjitha shoqatat që e përbëjnë atë kanë status të njëjte, përgjegjësi dhe detyrime për të ndihmuar njëra-tjetrën, dhe vepron në mbarë botën.

Misioni: Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është organizatë humanitare që punon në parandalimin dhe zbutjen e vuajtjeve njerëzore, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit, përmirësimin e gjendjes sociale, duke siguruar respekt dhe dinjitet për qenien njerëzore, e sidomos në rast të fatkeqësive dhe katastrofave, promovon të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe vlerat humane, inkurajon angazhimin vullnetar dhe gatishmërinë e përhershme për të dhënë ndihmë, si dhe ndjenjën universale për solidaritet dhe humanizëm.

Vizioni: Veprojmë, inkurajojmë dhe promovojmë vlera humane për të reaguar në kohë ndaj sfidave bashkëkohore humanitare, njëkohësisht jemi të vendosur për të bërë më shumë, për të bërë atë sa më mirë dhe për të arritur sa më larg.

Në bazë të nenit 3 paragrafi 2 i Ligjit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare nr.41/94) nga Kuvendi i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më datë 01.03.2017 u miratua

STATUTI

i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Kryqi i kuq i RM-së) është e vetmja organizatë që vepron në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe përbëhet nga organizatat komunale të Kryqit të kuq (në tekstin e mëtejshëm: organizatat komunale) dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit.

Kryqi i kuq i RM-së është organizatë humanitare, vullnetare, e paanshme, neutrale, jofitimprurëse, universale dhe e pavarur e qytetarëve të RM-së dhe në punën e vet promovon shërbimin vullnetar.

Kryqi i kuq i RM-së është organizatë e pavarur dhe autonome, që ka rol ndihmës për autoritetet shtetërore në realizimin e aktiviteteve humanitare, duke ruajtur autonominë që i lejonte veproje vazhdimisht në përputhje me Parimet themelore të Lëvizjes.

Kryqi i kuq i RM-së në punën e vet i përmbush kushtet e përcaktuara me nenin 4 të Statutit të Lëvizjes, në përputhje me nenin 3 të Statutit dhe detyrimet e përcaktuara me nenin 8 të Statutit të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Neni 2

Kryqi i kuq i RM-së, qëllimet dhe detyrat e veta i realizon në përputhje me Kushtetutën e RM-së, Ligjin e Kryqit të kuq të RM-së dhe Statutit të vet.

Neni 3

Kryqi i kuq i RM-së në realizimin e detyrave të veta udhëhiqet nga Parimet themelore të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, dhe nga dispozitat e Konventave të Gjenevës dhe Protokollet Shtesë.

Neni 4

Në përputhje me Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollet Shtesë të vitit 1977 dhe 2005, rregulloret e vitit 1991 për përdorimin e emblemës së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe të Shoqatave nacionale, Ligji i Kryqit të kuq i Republikës së Maqedonisë, emblema e Kryqit të kuq të RM-së është – Kryqi i kuq me pesë kuadrate të barabarta në bazë të bardhë.

Flamuri i Kryqit të kuq të RM-së është – Kryqi i kuq në bazë të bardhë, i vendosur në vendin ku kryqëzohen diagonalet, kurse raporti i gjatësisë dhe gjerësisë së flamurit është 2:1.

Logoja e Kryqit të kuq të RM-së është e vetmja për të gjitha nivelet organizative dhe përdorimi i saj i unifikuar është rregulluar me Standardet e brendimit (vendosjes së markës) të Kryqit të kuq të RM-së.

Përdorimi dhe mbrojtja e emblemës dhe e emrit të Kryqit të kuq të RM-së janë të rregulluar me ligj.

Vula e Kryqit të kuq të RM-së është – në mes ka një emblemë të Kryqit të kuq, nën emblemën mbishkrimi - Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, Shkup

Vula e rrumbullakët e Kryqit të kuq të RM-së është – në mes ka emblemën e Kryqit të kuq, përreth emblemës mbishkrimi – Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, Shkup .

Neni 5

Titulli i Shoqatës nacionale është Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë. Kryqi i kuq i RM-së ka cilësinë e personit juridik, i regjistruar në përputhje me dispozitat ligjore, me llogari të vetën bankare dhe me seli në Shkup, Bul. Koca Racin nr. 13, që është selia e Zyrës Qendrore të Kryqit të kuq të RM-së.

KAPITULLI II

QËLLIMET DHE DETYRAT

Neni 6

Qëllimi kryesor i Kryqit të kuq të RM-së është zbutja e vuajtjeve njerëzore, dhënia e ndihmës për personat në rast të konflikteve të armatosura, konfliktet e brendshme, situatat emergjente dhe katastrofat natyrore, përmirësimi i gjendjes së personave të rrezikuar që janë të ekspozuar ndaj rrezikut që rrezikon ekzistencën e tyre dhe mundësinë e jetesës me siguri minimale sociale dhe ekonomike dhe dinjitet njerëzor, parandalimin e sëmundjeve dhe ngritjen e kulturës shëndetësore, inkurajime e vullnetarizmit, solidaritetit dhe ndihmës së ndërsjellët, pa diskriminim në bazë nacionale, racore, gjinore, fetare, gjuhësore, përcaktimit gjinor dhe orientimit seksual, gjendjes shoqërore dhe përcaktimit politik, dhe në asnjë bazë tjetër.

Neni 7

Detyrat e Kryqit të kuq të RM-së:

1. Kryen detyrat që dalin nga dispozitat e Konventave të Gjenevës dhe Protokollet Shtesë;
2. Organizon, nxit dhe aftëson qytetarët për ruajtjen e shëndetit, parandalimin e varësive dhe përmirësimin e kushteve të jetesës;
3. Punon në motivimin, avancimin dhe masivizimin e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë, mbi parimet e vullnetarizmit, anonimitetit dhe dhurimit falas;
4. Kontribuon në zbutjen e problemeve sociale dhe uljen e dobësive të popullatës;
5. Merr pjesë në sigurimin dhe bën shpërndarjen e ndihmave humanitare të shoqatave të tjera nacionale, Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq dhe Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe, organizatat humanitare ndërkombëtare dhe nacionale dhe sektori i korporatave;
6. Siguron përkujdesje shëndetësore dhe organizon, mbledh dhe shpërndan ndihmat humanitare dhe shëndetësore qytetarëve për të zbutur dhe eliminuar pasojat e fatkeqësive natyrore, epidemive, katastrofave dhe konflikteve të armatosura;
7. Merr pjesë në aksione të solidaritetit ndërkombëtar në rast të fatkeqësive elementare dhe të tjera;
8. Aftëson dhe ndihmon popullsinë si të veprojë në rast të katastrofave dhe organizon dhe aftëson ekipe dhe njësi për reagim gjatë katastrofave;
9. Siguron sipërfaqe ujore dhe organizon shpëtimin në ujë dhe male;
10. Aftëson kuadro për siguri në ujë dhe male;
11. Organizon dhe udhëheq punën e Shërbimit për gjetje – Rivendosjen e lidhjeve familjare;
12. Promovon Parimet themelore të Lëvizjes, Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë, dhe respektimin e Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe vlerave humane;
13. Merr pjesë në aftësimin e popullatës për dhënien e ndihmës së parë;
14. Organizon kurse të ndihmës së parë për mbrojtjen gjatë punës dhe kurse të tjera për nevojat e personave juridikë;
15. Organizon kurse të ndihmës së parë për kandidatët për shoferë të automjeteve dhe mjeteve lundruese;
16. Organizon, aftëson, përsos dhe kryen ripërtëritjen e njohurive të instruktorëve dhe ligjëruesve të ndihmës së parë;
17. Organizon shërbime dhe aftëson kuadro për t'u kujdesur për të sëmurët dhe personat e moshuar dhe zhvillon forma për mbrojtjen jashtë-institucionale të personave të moshuar;
18. Me institucionet dhe organizatat kompetente merr pjesë në pranimin, akomodimin dhe përkujdesjen e popullatës së goditur dhe të pambrojtur, emigrantet, refugjatët, azilkërkuesit, viktimat e tregtisë me njerëz, viktimat e dhunës familjare etj.;
19. Bashkëpunon me institucionet dhe organizatat kompetente për respektimin e të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të kuq;
20. Bën vlerësimin e nevojave të komunitetit dhe në mënyrë të duhur ofron ndihmë, kurse për të mirën gjithëpërfshirëse kryen edhe punë të tjera të përcaktuara sipas dispozitave pozitive ligjore;
21. Informon publikun për aktivitetet e veta;

22. Bashkëpunon me Federatën ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe dhe me Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq, shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe me organe të tjera dhe organizata dhe agjenci humanitare;

Veprimtaria e Kryqit të kuq është me rëndësi publike për Republikën e Maqedonisë, kurse qëllimet e përcaktuara dhe detyra humanitare në fushën e shëndetësisë, mbrojtjes së të mirave materiale dhe shpëtimin e personave nga katastrofat natyrore, konfliktet e armatosura dhe raste të tjera të dhunës, rivendosjen e lidhjeve familjare, mbrojtjen sociale, edukimin dhe arsimimin, si dhe promovimin e së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, Kryqi i kuq i RM-së i kryen si autorizime publike, duke u udhëhequr nga Parimet themelore, Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë.

Kontratat e lidhura me organizatat apo entitetet e tjera, sidomos me autoritetet publike lidhur me kryerjen e shërbimeve publike, do të jenë në formën e shkruar dhe në asnjë rast nuk paraqesin detyrim për Shoqatën nacionale për të vepruar në kundërshtim me Parimet themelore.

Neni 8

Për të realizuar në mënyrën më të suksesshme qëllimet dhe detyrat programore me interes publik dhe autorizimet publike, organet dhe organizatat shtetërorë Kryqit të kuq të RM-së i mundësojnë prioritete, lehtësime tatimore, doganore dhe lehtësime të tjera ligjore dhe financiare, si dhe ndihma të tjera.

Në përputhje me paragrafin e mësipërm të këtij neni, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe qyteti i Shkupit, sigurojnë mjete nga buxhetet e tyre për organizatat komunale dhe Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit për realizimin e aktiviteteve programore.

Neni 9

Kryqi i kuq i RM-së organizon dhe shënon manifestimet tradicionale, aksione dhe aktivitete të përcaktuara me Ligjin e Kryqit të kuq të RM-së dhe kalendarin e aktiviteteve

KAPITULLI III

BVULLNETARIZMI DHE ANËTARËSIA

VULLNETARIZMI

Neni 10

Kryqi i kuq i RM-së njih, promovon dhe vlerëson vullnetarizmin, përfshin vullnetarët në aktivitetet programore të Kryqit të kuq të RM-së dhe ka përgjegjësi ndaj tyre.

Vullnetarizmi në Kryqin e kuq të RM-së është me rëndësi të veçantë për organizatën dhe paraqet një aktivitet të motivuar nga dëshira e lirë e personit për të shërbyer në mënyrë vullnetare, pa qenë i nxitur nga dëshira për përfitim material apo financiar që nuk është nën ndonjë ndikim të jashtëm, social, ekonomik apo politik.

Vullnetarizmi i dedikohet popullatës së pa mbrojtur në komunitetet në përputhje me parimet themelore të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe kontribuon në përforcimin e shoqërisë civile.

Vullnetari i Kryqit të kuq të RM-së është personi i cili në mënyrë vullnetare me kontributin, entuziazmin dhe angazhimin e tij kryen punë për Kryqin e kuq të RM-së dhe ndihmon në përmirësimin e jetës së popullatës të lënduar, para së gjithash në nivel lokal, pa përfitim material.

Angazhimi vullnetar është evidentuar, kurse vullnetari sipas nevojës është në dispozicion për të punuar në Kryqin e kuq të RM-së.

Neni 11

Vullnetarët e Kryqit të kuq të RM-së kanë këto obligime:

- Të promovojnë vlerat e shërbimeve vullnetare;;
- Të respektojnë Ligjin, Statutin dhe aktet tjera të Kryqit të kuq të RM-së;
- Të respektojnë dhe shpërndajnë, parimet bazë të Lëvizjes;
- Të punojnë sipas standardeve të përcaktuara;
- Të sillen në përputhshmëri me Kodin e sjelljes së vullnetarëve në Kryqin e kuq të RM-së.

Neni 12

Vullnetarët e Kryqit të kuq të RM-së kanë të drejtë për:

- Trajnim të duhur për përmbushjen e angazhimeve të dhëna;
- Pajisjen e duhur në përputhje me detyrat e parashtruara;
- Mundësi për zhvillim personal;

- Respektimin e mendimeve dhe ideve personale gjatë realizimit të aktiviteteve përkatëse;
- Vlerësimin dhe njohjen e kontributit të tyre;

Neni 13

Vullnetarizmi në Kryqin e kuq të RM-së është rregulluar me akt të veçantë.

ANTARESIMI

Neni 14

Anëtarësimi është status formal-juridik në Kryqin e kuq të RM-së.

Anëtarësimi në Kryqin e kuq të RM-së është vullnetar dhe i hapur për të gjithë.

Anëtar i Kryqit të kuq të RM-së mund të jetë çdo person që pranon këtë statut dhe vullnetarisht nënshkruan një aplikim për anëtarësim.

Neni 15

Anëtari i Kryqit të kuq të RM-së është person i cili në mënyrë aktive është i përfshirë në punën e Kryqit të kuq të RM-së, mbështet dhe kontribuon për zhvillimin e Kryqit të kuq të RM-së, mund të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organet dhe trupat e Kryqit të kuq të RM-së dhe paguan anëtarësim vjetor.

Mbështetësi është personi i cili nuk është i përfshirë aktivisht në punën e Kryqit të kuq të RM-së, por me pagesën e anëtarësimit apo në mënyrë tjetër ndihmon dhe mbështet shoqatën nacionale dhe ka të drejtën të jetë i informuar në mënyrë periodike për të gjitha aspektet e punës së shoqatës nacionale, dhe nuk mund të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organet dhe trupat e Kryqit të kuq të RM-së, derisa nuk angazhohet në mënyrë aktive në punën e Kryqit të kuq të RM-së.

Anëtar nderi është personi që ndihmon shoqatën nacionale dhe me meritat dhe mbështetjen e tij kontribuon në mënyrë të veçantë në zhvillimin e Kryqit të kuq të RM-së, nuk mund të zgjedhë e as të jetë i zgjedhur në organet dhe trupat e Kryqit të kuq të RM-së, dhe nuk është i obliguar për të paguar tarifën vjetore të anëtarësimit.

Anëtar nderi dhe kryetar nderi mund të shpallë Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së.

Neni 16

Anëtarët kanë këto obligime:

- Të respektojnë dhe shpërndajnë Parimet themelore;
- Të avancojnë dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në punën e Kryqit të kuq të RM-së;
- Të pranojnë dhe respektojnë Statutin;
- Të respektojnë dhe mbrojnë emblemën e Kryqit të kuq të RM-së;
- Të paguajnë tarifë vjetore për anëtarësim.

Neni 17

Anëtarët kanë këto të drejta:

- Të marrin pjesë në punën e Shoqatës nacionale;
- Të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur në organet dhe trupat e Shoqatës nacionale;
- Të aftësohen për të kryer detyra konkrete të Shoqatës nacionale;
- Të parashtrojnë propozime dhe pyetje dhe të iniciojnë tema diskutimi në strukturat e Shoqatës nacionale;
- Të vlerësohet dhe të pranohet kontributi i tyre.

Neni 18

Anëtarësimi në Kryqin e kuq të RM-së ndërpritet:

- Me dorëzimin e deklaratës me shkrim për dorëheqje;
- Me mos pagimin e tarifës vjetore të anëtarësimi;
- Përgjashtim.

Neni 19

Organizata komunale përjashton një anëtar nga anëtarësimi në këto raste:

- Shkelja e parimeve themelore të Lëvizjes;
- Mosrespektimi i Statutit të Kryqit të kuq të RM-së, Statutit të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe të organizatave komunale;
- Anëtarësimi në Kryqin e kuq të RM-së keqpërdoret për përfitim personal;
- Keqpërdorimi i emblemës së Kryqit të kuq;
- Angazhimi në aktivitete që dëmtojnë imazhin e Kryqit të kuq të RM-së.

Neni 20

Procedura e pranimit dhe përfundimit të anëtarësisë në Shoqatën nacionale, masat që duhet ndërmarre dhe e drejta e ankesës janë të rregulluar me një akt të veçantë.

KAPITULLI IV

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 21

Kryqi i kuq i RM-së është organizuar në :

1. Nivel nacional
2. Nivel të qytetit të Shkupit
3. Nivel komunal
4. Nivel themelor

UDHËHEQJA

Neni 22

Struktura udhëheqëse e Kryqit të kuq të RM-së:

1. Kuvendi
2. Kryetari
3. Nënkryetari
4. Këshilli udhëheqës

Neni 23

Profili i anëtarëve të strukturave udhëheqëse të Shoqatës nacionale duhet të mundësojë veprimin në përputhje me parimet themelore.

Anëtarët e strukturave udhëheqëse veprojnë vetëm në interes të qëllimeve të Shoqatës nacionale.

Anëtarët e strukturave udhëheqëse zgjidhen në përputhje me Rregullat e zbatimit të zgjedhjeve dhe verifikimit të procesit zgjedhor në Kryqin e kuq të RM-së.

Pavarësia e personave udhëheqës ka rëndësi të veçantë për sigurimin e veprimit të paanshëm dhe neutral në komunitet.

Anëtarët e strukturave udhëheqëse pasqyrojnë larminë e Shoqatës nacionale. Trupat udhëheqës janë të larmishëm në përbërjen e tyre dhe anëtarët e tyre janë individë nga radhë të shtresave, strukturave dhe grupeve të ndryshme shoqërore.

Për anëtarët e strukturave udhëheqëse të gjitha niveleve të Shoqatës nacionale zgjidhen persona kompetentë me kualifikime dhe kapacitete përkatëse, të entiteteve të ndryshme, profesione – fusha të punës, përcaktime politike dhe besime, me njohuri për

organizatën dhe përkushtim në realizimin e aktiviteteve të Shoqatës nacionale. Anëtarët e strukturave udhëheqëse është e dëshirueshme të kenë njohuri për programet dhe projektet, dhe të posedojnë aftësi për planifikim, menaxhim, sigurim të parave, komunikim dhe marketing.

Zgjedhje e anëtarëve të strukturave udhëheqëse bëhet pa asnjë diskriminim në bazë përkatësie etnike, racore, gjinore, fetare, gjuhësore, përcaktimit gjinor apo orientimit seksual, pozitës shoqërore dhe përcaktimit politik, apo në çfarëdo lloj baze tjetër.

K U V E N D I

Neni 24

Kuvendi i Kryqit të kuq i RM-së është organi më i lartë udhëheqës i Organizatës së Kryqit të kuq të RM-së.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve është 59 (pesëdhjete e nëntë).

Kuvendi përbëhet:

- Anëtarët e zgjedhur të propozuar nga organizatat komunale;
- Anëtarët e zgjedhur të propozuar nga të rinjtë e Kryqit të kuq të RM-së;

Mbledhjet e Kuvendit i kryeson kryetari i Kryqit të kuq të RM-së, kurse në mungesë të tij nënkryetari.

Në mbledhjet e Kuvendit merr pjesë edhe sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq të RM-së, i cili ka rol këshillëdhënës pa të drejtë vote.

Në mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të pranishëm edhe persona të tjetër të ftuar, në cilësinë e mysafirëve dhe vëzhguesve pa të drejtë vote.

Organizatat komunale të cilat dy vjet para zgjedhjeve nuk i kanë shlyer obligimet lidhur me kontributet financiare ndaj Kryqit të kuq të RM-së, nuk kanë të drejtë për të zgjedhur përfaqësues në Kuvendin e Kryqit të kuq të RM-së.

Përfaqësuesit për të cilët organizatat komunale në dy vitet e para të mandatit të tyre nuk i kanë shlyer obligimet lidhur me kontributet financiare ndaj Kryqit të kuq të RM-së, humbin të drejtën e votës.

Organizatat komunale të cilat së paku një vit nuk i kanë shlyer detyrimet financiare ndaj Kryqit të kuq të RM-së që dalin nga kompetencat e bartura të rregulluara me anë të marrëveshjeve, e humbin të drejtën e zbatimit të aktiviteteve që dalin nga ato marrëveshje.

Kriteret, kuota dhe struktura e përfaqësuesve të propozuar të Kuvendit verifikohet me vendimin e Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së, në bazë të numrit të banorëve të njërive të vetëqeverisjes lokale që janë mbuluar nga organizata komunale me punën e saj.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit është 4 (katër) vjet me mundësinë edhe për dy mandate të njëpasnjëshme.

Kompetencat e Kuvendit:

1. Miraton Statutin e Kryqit të kuq të RM-së dhe kryen ndryshimin dhe plotësimin sipas procedurës për miratimin e tij;
2. Propozon para organeve kompetente ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Kryqit të kuq;
3. Miraton Rregulloren e punës së Kuvendit;
4. Zgjedh kryetarin e Shoqatës nacionale dhe dy nënkryetarë me votim të fshehtë;
5. Zgjedh anëtarët e Këshillit udhëheqës me votim të fshehtë;
6. Zgjedh kryetarin dhe anëtarët e Komisionit financiar të Kryqit të kuq të RM-së me votim të fshehtë;
7. Miraton Planin strategjik për zhvillim të Shoqatës nacionale;
8. Verifikon programim e punës dhe Planin financiar si kompetencë e bartur për t'u miratuar nga Këshilli udhëheqës;
9. Miraton Raportin vjetor të punës dhe Raportin vjetor financiar i propozuar nga Këshilli udhëheqës;
10. Miraton vendimin për formimin, bashkimin, ndërprerjen dhe shpërbërje të Kuvendit të organizatave komunale dhe të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit me shumicë 2/3 (dy të tretat) të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit me të drejtën e votës;
11. Miraton aktin për kushtet dhe procedurën për krijimin, bashkimin dhe ndërprerjen e aktiviteteve të organizatave komunale dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit;
12. Miraton akt për kushtet dhe procedurën për shpërbërjen e Kuvendit të organizatave komunale dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe për marrjen e të drejtës për të përdorur emrin Kryqi i kuq dhe emblemën e Shoqatës nacionale për organizatat komunale dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit;
13. Miraton akt për anëtarësim dhe përjashtim nga anëtarësia në Organizatën;
14. Miraton vendim për shkarkimin e një anëtari të Kuvendit edhe para përfundimit të mandatit;
15. Miraton Kodeks të sjelljes për anëtarët e Këshillit udhëheqës;
16. Miraton Politikat për kapërcimin e konflikteve të interesit tek anëtarët e strukturave udhëheqëse;
17. Miraton kontratat që janë kontraktuar nga Këshilli udhëheqës apo sekretari i përgjithshëm me organizata të tjera, e të cilat kanë implikime financiare për organizatat komunale dhe Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit;
18. Miraton vendim për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Shoqatën nacionale, si dhe për ndërprerjen apo vazhdimin e mandatit;
19. Miraton akte të përgjithshme, vendime, konkluzione dhe akte të tjera me interes dhe rëndësi për Organizatën.

Neni 26

Kuvendi mban së paku një mbledhje të rregullt gjatë vitit.

Mbledhjet e Kuvendit thirren nga kryetari i Shoqatës nacionale.

Kryetari është i detyruar për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme edhe me kërkesën e 1/3 (një të tretës) të anëtarëve të Kuvendit apo me kërkesën e sekretarit të përgjithshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga iniciativa e ngritur.

Në qoftë se kryetari nuk e thërret mbledhjen, iniciativa e thirrjes duhet të mbështetet nga më shumë se 1/2 (gjysma) e anëtarëve të Kuvendit me të drejtën e votës për t'u mbajtur mbledhja.

Në qoftë se kryetari apo nënkryetari nuk e kryeson mbledhjen e jashtëzakonshme, ajo kryesohet nga anëtari më i moshuar nga mesi i iniciuesve.

Neni 27

Kuvendi punon në qoftë se në mbledhje janë të pranishëm më shumë se 1/2 (gjysma) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit me të drejtë të votës dhe vendimet dhe konkluzionet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, nëse nuk është paraparë një shumicë tjetër e kualifikuar.

Në rast të një votimi të barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Gjatë thirrjes së mbledhjes në qoftë se nuk është arritur kuorumi i nevojshëm, mbledhja shtyhet.

Në qoftë se bëhet fjalë për një situatë urgjente dhe të ngutshme mbledhja thirret sërish në 48 (dyzetetë) orët e ardhshme me ç' rast Kuvendi punon nëse në mbledhje janë të pranishëm më shumë se 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit me të drejtë të votës dhe vendimet dhe konkluzionet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Situata urgjente dhe e ngutshme është definuar me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Neni 28

Kuvendi mund të shpërndalet me vendimin e marrë nga shumica 2/3 (dy të tretat) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote.

KËSHILLI UDHËHEQËS

Neni 29

Këshilli udhëheqës është trup i Kuvendit që udhëheq me Kryqin e kuq të RM-së në mes të mbledhjeve të Kuvendit.

Këshilli udhëheqës është i përbërë nga anëtarët e zgjedhur nga radhët e Kuvendit.

Numri i anëtarëve të Këshillit udhëheqës është 13 (trembëdhjetë).

Kryetari dhe nënkryetari i Kryqit të kuq të RM-së sipas funksionit janë edhe anëtarë të Këshillit udhëheqës.

Kryetari i Kryqit të kuq të RM-së kryeson mbledhjen e Këshillit udhëheqës.

Mandati i anëtarëve të Këshillit udhëheqës zgjat 4 (katër) vjet me mundësinë edhe për një mandat të njëpasnjëshëm.

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit udhëheqës kryhet me votim të fshehtë.

Në qoftë se një anëtar i Këshillit udhëheqës mungon pa arsye në tri mbledhje të Këshillit udhëheqës ngrihet procedura për ndërprerjen e mandatit të tij.

Në mbledhjet e Këshillit udhëheqës merr pjesë edhe sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq të RM-së, i cili ka rolin këshillëdhënës pa të drejtë vote.

Neni 30

Këshilli udhëheqës mban së paku katër mbledhje gjatë vitit dhe sipas nevojës edhe më shumë.

Mbledhjet e Këshillit udhëheqës thirren nga kryetari i Kryqit të kuq të RM-së.

Kryetari është i detyruar të thërret mbledhje të jashtëzakonshme edhe me kërkesën e 1/3 (një të tretës) të anëtarëve të Këshillit udhëheqës apo me kërkesën e sekretarit të përgjithshëm në afat prej (pesëmbëdhjetë) ditëve nga iniciativa e ngritur.

Në qoftë se kryetari nuk e thërret mbledhjen, iniciativa për thirrjen duhet të mbështetet nga më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit udhëheqës për t'u mbajtur mbledhja.

Në qoftë se kryetari apo nënkryetari nuk kryeson mbledhjen e jashtëzakonshme, atëherë ajo kryesohet nga anëtari më i moshuar nga mesi i iniciuesve.

Këshilli udhëheqës punon në qoftë se në mbledhje marrin pjesë më shumë se 1/2 (gjysma) e anëtarëve të Këshillit udhëheqës dhe vendimet dhe konkluzionet merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm me të drejtën e votës.

Në rast të një votimi të barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Vendimi i sjellë nga Këshilli drejtues është i kontestuar nga kryetari i Kryqit të Kuq si kundërshtim me të dispozitave pozitive ligjore, Ligji i Kryqit të Kuq dhe të këtij Statuti, kryetari ka të drejtën e vetos.

Në qoftë se pas vendimit të kontestuar Këshilli Drejtues diskuton përsëri dhe adoptuar të njëjtin tekst, kryetari më nuk ka të drejtë në veto.

Gjatë thirrjes së mbledhjes në qoftë se nuk arrihet kuorumi i nevojshëm, mbledhja shtyhet.

Në qoftë se vlerësohet se bëhet fjalë për një situatë urgjente dhe të ngutshme mbledhja sërish thirret në 48 (dyzetetë) orët e ardhshme me ç' rast Këshilli udhëheqës punon nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit udhëheqës me të drejtën e votës, dhe vendimet dhe konkluzionet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Situata urgjente dhe e ngutshme është definuar me Rregulloren e punës së Këshillit udhëheqës.

Në situatën kur nuk ka mundësi për të mbajtur mbledhje, kryetari dhe nënkryetari ndërmarrin aktivitete dhe mund të marrin vendime, të cilat i paraqesin në një vërtetim për Këshillin udhëheqës në mbledhjen e ardhshme.

Në mbledhjen e Këshillit udhëheqës mund të jenë të pranishëm edhe persona të tjerë, personalitete publike dhe persona ekspertë të ftuar me propozimin e kryetarit apo të sekretarit të përgjithshëm.

Anëtarët e Këshillit udhëheqës për punën e tyre përgjigjen para Kuvendit.

Neni 31

Kompetencat e Këshillit udhëheqës:

1. Miraton Programin e punës dhe Planin financiar, si kompetencë e bartur nga Kuvendi;
2. Merr vendim për paraqitjen e llogarisë përfundimtare;
3. Përcakton Propozim-Raport të punës Propozim-Raport financiar dhe ia dorëzon Kuvendit;
4. Miraton strategji për veprimtaritë në përputhje me Planin strategjik të zhvillimit të organizatës;
5. Vendosni për themelimin e trupave të përhershëm këshillimor në organizatën e Kryqit të Kuq të RM dhe shikon dhe miraton raportet për punën e tyre;
6. Siguron realizueshmëri afatgjate të vendimeve, konkluzioneve, rekomandimeve dhe politikave të Kuvendit, dhe merr vendime për prioritetet dhe promovon kulturën e realizimit të qëllimeve të parashtruara;
7. Realizon aktivitete në planin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në një situatë kur nuk ka mundësi për të mbajtur mbledhje, kryetari dhe sekretari i përgjithshëm ndërmarrin aktivitete dhe informojnë Këshillin udhëheqës në mbledhjen e ardhshme;
8. Merr vendime për kriteret, kuotën dhe strukturën e përfaqësuesve të zgjedhur të anëtarëve në organizatën të Kuvendit të Kryqit të kuq të RM-së;

9. Miraton Rregullat e zbatimit të zgjedhjeve dhe verifikimin e procesit zgjedhor në Kryqin e kuq të RM-së;
10. Përcakton propozime për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe kryetarit të Komisionit financiar, sipas propozimit të Komisionit të organizimit, zhvillimit dhe burimeve njerëzore;
11. Emëron përfaqësues për përbërjen e organeve kompetente dhe të institucioneve të tjera;
12. Miraton aktin e kriterëve për emërimin dhe shkarkimin e sekretarit të përgjithshëm;
13. Emëron dhe shkarkon sekretarin e përgjithshëm në përputhje me aktin e emërimit dhe shkarkimit;
14. Jep pëlqim për emërimin e sekretarit të organizatës komunale / Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit me propozim të sekretarit të përgjithshëm të Kryqit të kuq të RM-së;
15. Jep pëlqim për Rregulloren për organizimin dhe punën të rinjve të kryqit të kuq të RM-së;
16. Miraton aktin e përgjithshëm për verifikimin e përgjegjësisë së organizatave komunale dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit;
17. Kufizon të drejtën e përdorimit të emrit Kryqi i kuq dhe të emblemës së Shoqatës nacionale për organizatat komunale, Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit, organizatat themelore dhe Këshillin e të rinjve, deri në marrjen e vendimit nga ana e Kuvendit;
18. Miraton Politikat e kapërcimit të një konflikti të interesit tek strukturat drejtuese dhe të punësuarit e Kryqit të kuq të RM-së;
19. Miraton kontratat e bashkëpunimit ndërkombëtar të organizatave komunale dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit para kontraktimit të tyre;
20. Emëron kryeredaktorin dhe anëtarët e Këshillit redaktues të revistës së Kryqit të kuq të RM-së;
21. Përcakton propozim-rendin e ditës për mbledhjet e Kuvendit;
22. Përshkruan formularin e aplikimeve dhe librezave të anëtarësimit;
23. Miraton Kodeksin e sjelljes së anëtarëve dhe vullnetarëve të Shoqatës nacionale;
24. Miraton aktin e përgjithshëm të organizatës dhe sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin profesional të Kryqit të kuq të RM-së, me propozim të sekretarit të përgjithshëm;
25. Miraton metodologjinë për numrin e vendeve të punës dhe llogaritjen e rrogave në Shoqatën nacionale, me propozim të sekretarit të përgjithshëm;
26. Miraton Rregulloren e pamjes – dizajnit dhe përdorimit të rrobave të punës – uniformës për të punësuarit dhe vullnetarët me propozim të sekretarit të përgjithshëm;
27. Miraton Standardet e brendimit (vendosjes së markës) të Kryqit të kuq të RM-së;
28. Merr vendime për tërheqjen dhe shpërndarjen e mjeteve financiare për organizatat komunale dhe Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit me propozim të sekretarit të përgjithshëm.
29. Merr vendime për krijimin e fondeve për mbledhjen dhe shpërndarjen e mjeteve të mbledhura, puna e të cilave është përcaktuar me rregullore të veçantë;
30. Miraton Rregulloren e organizimit dhe punës së trupave këshillëdhënëse;
31. Përcakton kalendarin për shënimin e aktiviteteve;

32. Miraton Rregulloren e dhënies së mirënjohjeve për aktivistët dhe organizatat e dalluara;
33. Shqyrton dhe miraton informacionet dhe raportet për aksionet dhe aktivitetet e zbatuara dhe informon organizatën, dhe sipas nevojës edhe publikun për të njëjtën;
34. Miraton aktin e përgjithshëm për krijimin, funksionimin, rolin, detyrat dhe aktivizimin e ekipeve dhe njësiteve të reagimit në katastrofa të Kryqit të kuq të RM-së;
35. Ka në dispozicion dhe menaxhon pronën e Kryqit të kuq të RM-së dhe jep miratimin paraprak për fillimin e procedurave të organizatave komunale / Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit për shitjen e pasurisë me vlerë mbi 100.000 euro në kundërvlerë në denarë dhe pronë e cila është donacion ose e fituar me pjesëmarrjen e Shoqërisë Kombëtare;
36. Merr vendim për shitjen e pronës së Kryqit të kuq të RM-së me vlerë deri 300.000 euro në kundërvlerë të denarëve, ndërsa për shitjen e pronës kërkohet mendimi i Kuvendit;
37. Jep pëlqim për dhënien e së drejtës së përdorimit dhe shfrytëzimit të emblemës për subjekte të tjera në raste të parashikuara me Ligjin e Kryqit të kuq të RM-së;
38. Miraton rregulla për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të kuq të RM-së;
39. Merr vendim për kontribute financiare për përfaqësuesit e organizatave komunale në Kuvendin e Kryqit të kuq të RM-së;
40. Paraqet raport për zgjedhjet e mbajtura në Shoqatën nacionale për Kuvendin për miratim, paraprakisht i përgatitur nga Komisioni për zbatimin e zgjedhjeve dhe verifikimin e procesit zgjedhor;
41. Miraton vendime si organ i shkallës së dytë për ankesat që janë përfundimtare;
42. Miraton edhe akte të tjera të përgjithshme, vendime dhe konkluzione që janë të rëndësishme për Shoqatën nacionale.

KRYETARI

Neni 32

Kompetencat e Kryetarit:

1. E përfaqëson Organizatën brenda vendit dhe në plan ndërkombëtar;
2. Thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit dhe të Këshillit udhëheqës;
3. Ndjek zhvillimin dhe gjendjen e Shoqatës nacionale dhe informon Kuvendin;
4. Ndjek punën e komisioneve të Kryqit të kuq të RM-së të përcaktuara me këtë statut;
5. Merr vendim për shpalljen e zgjedhjeve të rregullta në të gjitha nivelet organizative në Shoqatën nacionale, më së voni 90 (nëntëdhjetë) ditë para përfundimit të mandatit të anëtarëve të Kuvendit, të cilat mbahen në përputhje me Rregullat e mbajtjes së zgjedhjeve dhe verifikimit të procesit zgjedhor në Kryqin e kuq të RM-së;

6. Kryen detyra që i janë besuar nga Kuvendi dhe Këshilli udhëheqës;
7. Nënshkruan vendimet dhe aktet tjera të përgjithshme të miratuara nga Kuvendi dhe Këshilli udhëheqës, si dhe vendimet në mes dy mbledhjeve të Këshillit udhëheqës të miratuara nga kryetari dhe nënkryetarët, të cilat paraqiten për t'u verifikuar në mbledhjen e ardhshme.

Kryetari disa nga funksionet e tij mund t'ia besojë njërit prej nënkryetarëve.

Në rast se vendi i kryetarit është lënë zbrazët, apo në rast se kryetari nuk ka mundësi për të kryer funksionin e tij, Këshilli udhëheqës emëron një nënkryetar i cili do ta ketë funksionin e kryetarit UD deri në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit apo deri në zgjedhjen e një kryetari.

Në këtë mbledhje, Kuvendi do të zgjedh një kryetar që do të plotësojë vendin e zbrazët deri në përfundimin e mandatit aktual të kryetarit.

Mandati i kryetarit zgjat 4 (katër) vjet, me mundësinë për një mandat të dytë të njëpasnjëshëm.

Zgjedhja e kryetarit kryhet me votim të fshehtë.

Kryetari për punën e tij përgjigjet para Kuvendit dhe Shoqatës nacionale.

N Ë N K R Y E T A R

Neni 33

Nënkryetari ndihmon kryetarit në kryerjen e detyrave të përcaktuara dhe kryen punë të tjera të besuara nga kryetari dhe në mungesë të tij e zëvendëson në të gjitha funksionet e përcaktuara me këtë statut.

Mandati i nënkryetarit zgjat 4 (katër) vjet, me mundësinë për një mandat të dytë të njëpasnjëshëm.

Zgjedhja e nënkryetarit kryhet me votim të fshehtë.

Nënkryetari për punën e tij përgjigjet para Kuvendit dhe Shoqatës nacionale.

Neni 34

Në rast se anëtari i strukturës udhëheqëse ka apo merr një pozitë të lartë në pushtetin publik – shërbim apo parti politike, jep dorëheqje nga pozita e tij në kryqin e kuq të RM-së.

Deri në pranimin e dorëheqjes së tij, anëtari i strukturës udhëheqëse do të përpiqet që puna-funksioni i tij në pushtetin publik gjegjësisht në shërbimin apo në partinë politike të mos shkaktojë konflikt interesi duke qenë anëtar në trupin udhëheqës. Në rast të një konflikti të interesit, anëtari i strukturës udhëheqëse nuk do

të merr pjesë në votim dhe në vendimmarrje, dhe konflikti i lartpërmendur i interesit do të zgjidhet vetëm në interes të Kryqit të kuq të RM-së.

KOMISIONI FINANCIAR

Neni 35

Komisioni financiar përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë të komisionit të zgjedhur nga mesi i anëtarëve të Kuvendit dhe persona të tjerë profesionalë, me mandat prej 4 (katër) vjetësh, me mundësinë për një mandat të dytë të njëpasnjëshëm të 1/2 (gjysmës) së anëtarëve.

Kryetari i Komisionit financiar zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Kuvendit.

Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit financiar kryhet me votim të fshehtë.

Në qoftë se anëtari i komisionit mungon pa arsye në tri mbledhje ngrihet procedura për ndërprerjen e mandatit të tij.

Neni 36

Kompetencat e Komisionit financiar:

1. Jep këshilla për të gjitha çështjet financiare që ndikojnë në punën e Kryqit të kuq të RM-së;
2. Jep mendim për raportin financiar dhe për planin financiar të Kryqit të kuq të RM-së;
3. Jep mendim për qëllimin dhe përdorimin e mjeteve financiare në dispozicion dhe propozon për Kuvendin dhe për Këshillin udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së se cilat masa financiare duhet të ndërmerren;
4. Ndjek qarkullimin e kontributeve financiare;
5. Këshillon sekretarin e përgjithshëm dhe Këshillin udhëheqës për zbatimin e vendimeve për punën financiare të Kryqit të kuq të RM-së që i ka miratuar Kuvendi;
6. Dorëzon mendim për punën financiare të Kryqit të kuq të RM-së për Këshillin udhëheqës;
7. Shqyrton raportin e revizorëve të jashtëm dhe sipas nevojës jep udhëzime veprimi për të njëjtën;
8. Me kërkesë të kryetarit të Kryqit të kuq të RM-së dhe sekretarit të përgjithshëm jep këshilla për çështjet e rrezikshme dhe çështjet tjera financiare që kanë ndikim në punën e Kryqit të kuq të RM-së.

KOMISIONET

Neni 37

Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së formon dhe emëron kryetarin dhe anëtarët të katër komisioneve të përhershme nga radhët e Kuvendit, anëtarësinë dhe personat tjerë profesionalë me mandat prej (katër) vjetësh me mundësinë për rizgjedhje, si vijon:

1. Komisionin për organizimin, zhvillimin dhe burimet njerëzore
2. Komisionin për Statutin dhe aktet normative
3. Komisionin për verifikimin dhe menaxhimin me rreziqet dhe revizionin
4. Komisionin për mbajtjen e zgjedhjeve dhe verifikimin e procesit zgjedhor.

Neni 38

Komisioni për organizimin, zhvillimin dhe burimet njerëzore përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë të Komisionit.

Komisioni për organizimin, zhvillimin dhe burimet njerëzore ndjek funksionimin dhe zhvillimin e strukturës organizative në Kryqin e kuq të RM-së, shqyrton dokumentet strategjike, programet dhe raportet e punës së Shoqatës nacionale dhe përcakton propozimet e kandidatëve për funksionet udhëheqëse në Kryqin e kuq të RM-së.

Neni 39

Komisionin për statutin dhe aktet normative e përbëjnë kryetari dhe gjashtë anëtarë të komisionit.

Komisioni për statutin dhe aktet normative inicion ndryshimet e Ligjit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe shqyrton propozimet për ndryshimin e Statutit të Kryqit të kuq të RM-së dhe aktet tjera të përgjithshme, jep pëlqim për statutet e organizatave komunale dhe të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, shqyrton vendimet dhe aktet tjera të përgjithshme dhe jep mendim për pajtueshmërinë e tyre me dispozitat pozitive ligjore.

Neni 40

Komisioni për verifikimin dhe menaxhimin me rreziqet dhe revizionin përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarët e Komisionit.

Komisioni për verifikimin dhe menaxhimin me rreziqet dhe revizionin kryen kontrollin, monitorimin dhe vlerësimin e punës së Kryqit të kuq të RM-së, Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale për të identifikuar, definuar dhe përcaktuar rreziqet, dhe propozon mënyrat e menaxhimit me rreziqet, si dhe masat dhe aktivitetet për parandalimin e parregullsive dhe aktiviteteteve të ndjeshme ndaj mashtrimit dhe kryen kontrollin mbi politikat e vendosura, procedurat financiare dhe

aktivitetet e tjera me qëllim që të sigurojë realizimin e qëllimeve dhe detyrave të Kryqit të kuq të RM-së dhe për të shmangur apo zvogëluar rreziqet dhe pasojat e dëmshme.

Neni 41

Komisioni për zbatimin e zgjedhjeve dhe verifikimin e procesit zgjedhor përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë.

Komisioni për zbatimin e zgjedhjeve dhe verifikimin e procesit zgjedhor zbaton zgjedhjet, jep udhëzime për përgatitjen dhe zbatimin e zgjedhjeve në organizatat komunale dhe në Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit, kryen verifikimin e procesit zgjedhor, organizon dhe ndjek paraqitjen zgjedhore të kandidatëve për kryetarë të Shoqatës nacionale dhe për punën e vet paraqet raport deri te Kuvendi i Kryqit të kuq të RM-së nëpërmjet Këshillit udhëheqës.

Neni 42

Me aktin e Këshillit udhëheqës në mënyrë të hollësishme është rregulluar mënyra dhe fusha e punës së komisioneve.

TRUPAT KËSHILLËDHËNËSE

Neni 43

Këshilli udhëheqës formon dhe emëron kryetarin dhe 6 (gjashtë) anëtarë të trupave këshillëdhënës në Kryqin e Kuq të RM dhe vendos të formojë organe të përhershme në organizatat e komunale/ Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit në përbërje nga një kryetar dhe katër (4) anëtarë

Këshilli udhëheqës sipas nevojës krijon trupa të përkohshëm këshillëdhënës në formë të komisioneve, qendrave operative dhe profesionale, grupe të punës etj.

Anëtarët në trupat këshillëdhënëse përveçse nga anëtarësia mund të jenë edhe persona të jashtëm profesionalë të fushës së trupit këshillëdhënës.

Me aktin e Këshillit udhëheqës është rregulluar numri, mënyra dhe fusha e punës e trupave të përhershme këshillëdhënëse.

TË RINJTË E KRYQIT TË KUQ

Neni 44

Anëtarët e Kryqit të kuq të RM-së të cilët janë persona të rinj veprojnë dhe punojnë në klubet e të rinjve të Kryqit të Kuq të RM në organizatat komunale dhe Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit nga të cilët zgjedhin përfaqësues në Këshillin rinor të Kryqit të Kuq të RM.

Kryqi i kuq i RM-së vazhdimisht punon në tërheqjen dhe përfshirjen e të rinjve në punën dhe aktivitetet e Kryqit të kuq, kryen trajnime, aftëson dhe promovon punën e tyre.

Organizimi dhe puna e të rinjve në Kryqi të kuq në RM është rregulluar me Rregulloren për organizimin dhe punën e Të rinjve të Kryqit të kuq në RM, për të cilin pëlqim jep Këshilli udhëheqës.

KAPITULLI V

ADMINISTRIMI

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Neni 45

Sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq të RM-së është person i emëruar dhe administron Shoqatën nacionale.

Neni 46

Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e sekretarit të përgjithshëm:

1. Përfaqëson organizatën para organeve kompetente;
2. Menaxhon me Shoqatën nacionale;
3. Emëron zëvendës sekretarin e përgjithshëm, pas pëlqimit paraprak të Këshillit udhëheqës për kandidatin që e ka propozuar;
4. Cakton persona në pozita udhëheqëse nga radhët e të punësuarve në Shërbimin profesional të Kryqit të kuq të RM-së;
5. Zbaton vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e miratuara nga Kuvendi dhe Këshilli udhëheqës;
6. Përgatit dhe menaxhon planin e miratuar financiar–buxhetin dhe paraqet raport për realizimin e tij;

7. Përgatit, ndjek dhe ndihmon realizimin e programeve të Kuvendit dhe Këshillit udhëheqës, ndjek punën e komisioneve dhe trupave këshillëdhënës;
8. Është i pranishëm dhe merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit dhe të Këshillit udhëheqës me një rol këshillëdhënës pa të drejtë vote;
9. Vendos për pranimin, ndërprerjen dhe strukturimin e të punësuarve në Shërbimin profesional të Kryqit të kuq të RM-së;
10. Koordinon dhe ndjek punën e sekretarëve të organizatave komunale të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit;
11. Jep propozim për pëlqim për emërimin e sekretarit të organizatës komunale / Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit për Këshillin udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së;
12. Jep pëlqim për emërimin e sekretarit u.d. në një organizatë komunale dhe në Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit;
13. Inicion procedurën për verifikimin e përgjegjësisë së sekretarit të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe të organizatës komunale për mos zbatimin e vendimeve të Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së dhe mos realizimin e detyrave të dhëna nga ana e sekretarit të përgjithshëm, dhe në qoftë se Këshilli udhëheqës i organizatës komunale nuk vepron sipas iniciativës, e informon Këshillin udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së për të ndërmarrë masa përkatëse;
14. Menaxhon aktivitetet e veprimit në rast të gjendjeve urgjente dhe katastrofave, jep instruksione për të vepruar, gjegjësisht ndërmerr masa për riparimin e pasojave të katastrofës;
15. Emëron anëtarë në trupat operative dhe koordinues të institucioneve dhe organeve kompetente, dhe për këtë informon Këshillin udhëheqës;
16. Miraton rregulla për rendin e punës dhe disiplinën e të punësuarve në Kryqin e kuq të RM-së.
17. Miraton Kodeksin e etikës afariste dhe sjelljen e të punësuarve në Kryqin e kuq të RM-së;
18. Për punën e tij përgjigjet para Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së;
19. Lidh kontrata dhe memorandume të bashkëpunimit në përputhje me vendimet e marra dhe politikat e Shoqatës nacionale.

Mandati i sekretarit të përgjithshëm zgjat 4 (katër) vjet me mundësinë për riemërim.

Sekretari i përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para përfundimit të mandatit nga Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së.

SHËRBIMI PROFESIONAL

Neni 47

Shërbimi profesional i Zyrës Qendrore të Kryqit të kuq të RM-së punon në sigurimin dhe realizimin e qëllimeve dhe detyrave programore dhe kryen punët materiale-financiare dhe administrative teknike.

Sekretari i përgjithshëm operacionalizon punën dhe udhëheq me Shërbimin profesional.

Të punësuarit në Shërbimin profesional për punën e tyre përgjigjen para sekretarit të përgjithshëm.

Shërbimi profesional mund të krijohet edhe në organizatat komunale dhe në Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit. I punësuarit në Shërbimin profesional të Kryqit të kuq të RM-së në të gjitha nivelet nuk mund të jetë anëtar i organeve të Shoqatës nacionale, por mund të merr pjesë në punën e tyre.

I punësuarit në Shërbimin profesional mund të jetë anëtar i Komisionit për verifikimin dhe menaxhimin me krizat dhe revizionin.

Me Rregulloren e Organizatës dhe sistematizimin e vendeve të punës janë rregulluar numri dhe titujt e vendeve të punës, kushtet të cilat të punësuarit duhet t'i plotësojnë për kryerjen e punëve, përshkrimi dhe regjistrimi i vendeve të punës dhe detyrave të punës të cilat të punësuarit në Shërbimin profesional i kryejnë.

Neni 48

Me qëllim të parandalimit të një konflikti të interesit, struktura udhëheqëse dhe të punësuarit në Shoqatën nacionale, me rastin e lidhjes së kontratës për angazhim të punës nënshkruajnë Deklaratë për konflikt të interesit që është pjesë përbërëse e kontratës për angazhimin e punës.

Konflikti i interesit në Shoqatën nacionale është zgjidhur në përputhje me politikat e kapërcimit të konflikteve të interesit tek struktura udhëheqëse dhe të punësuarit e Kryqit të kuq të RM-së.

KAPITULLI VI

ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KRYQIT TË KUQ TË RM-së

Neni 49

Format e organizimit të Kryqit të kuq të RM-së janë Zyra qendrore, Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, organizatat komunale dhe organizatat bazë. Zyra qendrore organizon punën e Kryqit të kuq të RM-së.

Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit funksionon në rajonin e qytetit të Shkupit.

Organizatrat komunale janë krijuar për një apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale të cilat i mbulojnë me punën e tyre.

Organizatata bazë janë krijuar sipas vendit të jetesës, punës dhe në institucionet arsimore.

ZYRA QENDRORE E KRYQIT TË KUQ TË RM-së

Neni 50

Puna e Kryqit të kuq të RM-së organizohet nga Zyra qendrore e Kryqit të kuq të RM-së me seli në Shkup dhe ajo ofron mbështetje për realizimin e programeve dhe politikave të Kryqit të kuq të RM-së.

Zyra qendrore jep udhëzime, këshilla dhe koordinon punën e organizatave komunale dhe të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit si mbështetje për punën e tyre në përputhje me nevojat në njësitë e vetëqeverisjes lokale të rajonit për të cilin janë krijuar.

Sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq të RM-së propozon strukturën e Zyrës qendrore, dhe për strukturën e përgjithshme vendos Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së.

Puna e shërbimeve në Zyrën qendrore është organizuar dhe ndjekur nga ana e sekretarit të përgjithshëm në përputhje me vendimet e Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së.

KRYQI I KUQ I QYTETIT TË SHKUPIT

Neni 51

Në rajonin e qytetit të Shkupit formon dhe realizon aktivitete Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, i cili koordinon punën e organizatave komunale në nivel të qytetit të Shkupit dhe realizon aktivitete në përputhje me nevojat dhe interesat e Qytetit.

Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit në punën e vet është i obliguar për të respektuar Statutin e Shoqatës nacionale dhe për të zbatuar vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e Shoqatës nacionale. Në veprimtarinë e vet përdor logon e vetme të Shoqatës nacionale.

Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit është në cilësi të personit juridik me llogarinë e vet bankare, vulën dhe vulën e rrumbullakët që përdoren në transaksionet juridike.

Vula e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit është – në mes ka emblemën e Kryqit të kuq, nën emblemën mbishkrimin – Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë – Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Vula e rrumbullakët e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit është – në mes ka emblemën e Kryqit të kuq, rreth emblemës mbishkrimin – Kryqi i kuq i Republikës së

Maqedonisë në gjuhën maqedonase dhe shqipe dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Organi më i lartë i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit është Kuvendi.

Kuvendi i Kryqit të kuq i qytetit të Shkupit përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga organizatat komunale në qytetin e Shkupit dhe të rinjtë e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

Kuvendi i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit numëron 27 (njëzeteshtatë) anëtarë, ndërsa Këshilli udhëheqës numëron 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë.

Numri dhe përbërja e anëtarëve të Kuvendit të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit caktohet me vendimin e Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

Zgjedhjet në Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit zbatohen në përputhje me Rregullat për zbatimin e zgjedhjeve dhe verifikimin e procesit zgjedhor në Kryqin e kuq të RM-së.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit zgjat 4 (katër) vjet me mundësinë edhe për dy mandate të njëpasnjëshme.

Kuvendi i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit nga anëtarët e vet zgjedh kryetarin e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe një nënkryetar me votim të fshehtë.

Kuvendi i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit zgjedh kryetarin dhe anëtarët e Këshillit udhëheqës dhe të Komisionit financiar me votim të fshehtë.

Kuvendi i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit krijon komisionet dhe trupat e punës dhe emëron anëtarët.

Mandati i kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Këshillit udhëheqës është 4 (katër) vjet, me mundësinë edhe për një mandat të njëpasnjëshëm.

Mandati i anëtarëve të Komisionit financiar është 4 (katër) vjet, me mundësinë për një mandat të dytë të njëpasnjëshëm të 1/2 (gjysmës) së anëtarëve.

Kryetari dhe nënkryetari sipas funksionit të tyre janë anëtarë të Këshillit udhëheqës.

Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit emëron sekretarin me mandat prej 4 (katër) vjetësh, me mundësinë për riemërim të serishëm, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së.

Sekretari i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit për punën e tij përgjigjet para Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe para sekretarit të përgjithshëm të Kryqit të kuq të RM-së.

Sekretari i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit mund të shkarkohet edhe para përfundimit të mandatit nga Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

ORGANIZATAT KOMUNALE

Neni 52

Organizatrat komunale janë krijuar dhe realizojnë aktivitetet për një apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale.

Organizatrat komunale në punën e tyre janë të obliguara për të respektuar Statutin e Shoqatës nacionale dhe për të zbatuar vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e Shoqatës nacionale. Në veprimtarinë e tyre përdorin logon e vetme të Shoqatës nacionale.

Organizatrat komunale janë në cilësinë e personit juridik me llogarinë e tyre bankare, vulën dhe vulën e rrumbullakët që përdoren në transaksionet juridike.

Vula e organizatës komunale është: në mes ka emblemën e Kryqit të kuq, nën emblemën mbishkrimin "Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë – Organizata komunale _____ (emërtimi i selisë) ".

Vula e rrumbullakët e organizatës komunale është: në mes ka emblemën e Kryqit të kuq, dhe rreth emblemës mbishkrimin "Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë – Organizata komunale _____ (emërtimi i selisë) ".

Në organizatën komunale e krijuar për një apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale e cila i mbulon me punën e saj, dhe në të cilën të paktën 20% të numrit të përgjithshëm të banorëve sipas regjistrimit të fundit të popullsisë janë pjesëtarë të një komuniteti të caktuar, mbishkrimi i vulës dhe i vulës së rrumbullakët të organizatës komunale të Kryqit të kuq, përveç gjuhës maqedonase dhe shkrimit të saj cirilik, shkruhet edhe në gjuhën e pjesëtarëve të atij komuniteti dhe shkrimit të tyre.

Organi më i lartë i organizatës komunale është Kuvendi.

Numri i anëtarëve të kuvendeve dhe këshillave udhëheqës të organizatave komunale është në proporcion me numrin e banorëve në njësinë e vetëqeverisjes lokale, të cilët organizatat komunale i mbulojnë me punën e tyre, si dhe në përputhje me numrin e përfaqësuesve të zgjedhur në Kuvendin e Kryqit të kuq të RM-së, të përcaktuar në Vendimin e Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së si vijon:

- Kuvendet e organizatave komunale që kanë 1 (një) përfaqësues në Kuvendin e Kryqit të kuq të RM-së, Kuvendi numëron 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë, ndërsa Këshilli udhëheqës numëron 7 (shtatë) anëtarë;
- Kuvendi i organizatave komunale që kanë 2 (dy) përfaqësues në Kuvendin e Kryqit të kuq të RM-së, Kuvendi numëron 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarë, dhe Këshilli udhëheqës numëron 7 (shtatë) anëtarë;
- Kuvendet e organizatave komunale që kanë 3 (tre) përfaqësues në Kuvendin e Kryqit të kuq të RM-së, Kuvendi numëron 21 (njëzet e një) anëtarë, dhe Këshilli udhëheqës numëron 9 (nëntë) anëtarë;

- Kuvendet e organizatave komunale që kanë 4 (katër) përfaqësues në Kuvendin e Kryqit të kuq të RM-së, Kuvendi numëron 23 (njëzet e tre) anëtarë, dhe Këshilli udhëheqës numëron 9 (nëntë) anëtarë.

Zgjedhjet në organizatat komunale zbatohen në përputhje me Rregullat e zbatimit të zgjedhjeve dhe verifikimin e procesit zgjedhor në Kryqin e kuq të RM-së.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit zgjat 4 (katër) vjet me mundësinë edhe për dy mandate të njëpasnjëshme.

Kuvendi i organizatës komunale nga anëtarët e vet zgjedh kryetarin e organizatës komunale dhe një nënkryetar me votim të fshehtë.

Kuvendi i organizatës komunale zgjedh kryetarin dhe anëtarët e Këshillit udhëheqës dhe të Komisionit financiar me votim të fshehtë.

Kuvendi i organizatës komunale krijon komisionet dhe trupat e punës dhe emëron anëtarët.

Mandati i anëtarëve të Këshillit udhëheqës, kryetari dhe nënkryetari është 4 (katër) vjet, me mundësinë edhe për një mandat të njëpasnjëshëm.

Mandati i anëtarëve të Komisionit financiar është 4 (katër) vjet, me mundësinë për mandat të dytë të njëpasnjëshëm të 1/2 (gjysmës) së anëtarëve.

Kryetari dhe nënkryetari i organizatës komunale sipas funksionit të tyre janë anëtarë të Këshillit udhëheqës.

Këshilli udhëheqës i organizatës komunale emëron sekretarin me mandat prej katër vjetësh, me mundësinë për riemërim të serishëm, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së.

Sekretari i organizatës komunale për punën e vet përgjigjet para Këshillit udhëheqës të organizatës komunale dhe para sekretarit të përgjithshëm të Kryqit të kuq të RM-së.

Sekretari i organizatës komunale mund të shkarkohet edhe para përfundimit të mandatit nga Këshilli udhëheqës i organizatës komunale

ORGANIZATAT BAZË

Neni 53

Vendimi për krijimin dhe ndërprerjen e organizatës bazë të Kryqit të kuq merret nga Këshilli udhëheqës i organizatës komunale.

Organizatrat bazë mund të jenë krijuar nga së paku dhjetë anëtarë sipas vendit të jetesës dhe punës së anëtarëve dhe në institucionet arsimore.

Në mbledhje organizatat bazë zgjedhin kryetarin dhe arkëtarin e organizatës bazë, ndërsa organizatat bazë të përcaktuara me vendimin e Këshillit udhëheqës të organizatës komunale zgjedhin edhe përfaqësuesit në organizatat komunale.

Organizatat bazë me mbi 30 anëtarë mund të zgjedhin këshill udhëheqës prej pesë anëtarëve të cilin e kryeson kryetari i organizatës bazë.

Në organizatat bazë ku ka më shumë njësi të organizimit, në Këshillin udhëheqës në mënyrën e duhur duhet të jenë të përfaqësuar anëtarët nga të gjitha njësitë e organizimit.

Mandati i anëtarëve të Këshillit udhëheqës zgjat 4 (katër) vjet me mundësinë edhe për një mandat të njëpasnjëshëm.

Mbikëqyrja e punës së organizatës bazë kryhet nga organizatat komunale.

Organizatat bazë të Kryqit të kuq punojnë në përputhje me dispozitat e Statutit të organizatës komunale dhe Statutit të Kryqit të kuq të RM-së.

KAPITULLI V

SHËRBIMI PËR KËRKESA – RIVENDOSJA E LIDHJEVE FAMILJARE

Neni 54

Për shkak të kryerjes së aktiviteteve dhe punëve që dalin apo që janë të përcaktuara me Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollat Shtesë të vitit 1977 dhe vitit 2005 dhe Ligjit të Kryqit të kuq të RM-së së vitit 1994, në Kryqin e kuq të RM-së është krijuar dhe punon Shërbimi për kërkesa – Rivendosja e lidhjeve familjare.

Republika e Maqedonisë siguron mjete për Kryqin e kuq të RM-së si bartës i autorizimeve publike për veprimtarinë e Shërbimit për kërkesa – Rivendosja e lidhjeve familjare për të pajisur kuadrin me materiale, zhvillimin dhe gatishmërinë e tij për të funksionuar në mënyrë më efikase në paqe, si dhe në rast të luftës, fatkeqësi masive natyrore dhe fatkeqësi të tjera.

Neni 55

Kryqi i kuq i RM-së mbledh, rregullon, ruan dhe jep të dhëna për viktimat e fatkeqësive masive natyrore dhe fatkeqësi të tjera dhe konflikte të armatosura.

Neni 56

Kryqi i kuq mund të japë shërbime për akomodimin dhe ushqimin dhe për nevoja të tjera për personat që kanë nevojë për një formë të tillë të ndihmës për arsye sociale, shëndetësore dhe të tjera, dhe në rast të situatave të jashtëzakonshme.

Kryqi i kuq mund të themelojë njësi afariste për dhënien e shërbimeve të paragrafit 1 të këtij neni, si dhe forma të tjera të organizimit të arsimit, trajnime për ngritjen e kapaciteteve etj.

Dhënia e shërbimeve për akomodim dhe ushqim nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk konsiderohet si veprimtari hoteliere.

Neni 57

Organizimi dhe mënyra e punës së Shërbimit për kërkesa – Rivendosja e lidhjeve familjare është rregulluar me aktin e veçantë i miratuar nga ana e Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së, për të cilin pëlqim jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

KAPITULLI VIII

BASHKËPUNIMI

Neni 58

Kryqi i kuq i RM-së realizon bashkëpunim ndërkombëtar me Federatën ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Komitetin ndërkombëtar, shoqatat nacionale dhe agjencitë e ndryshme ndërkombëtare ambasadat dhe përfaqësitë diplomatike – konsullore, , organet, organizatat joqeveritare dhe humanitare.

Kryqi i kuq i RM-së në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të veta bashkëpunon me Qeverinë e RM-së, ministritë, institucionet, agjencitë, kompanitë, organizatat joqeveritare dhe shoqatat dhe organizata tjera të cilat janë me interes të punës të Shoqatës nacionale në vend.

Aktivitetet e bashkëpunimit realizohen nëpërmjet këmbimit të përvojave të punës, me qëllim të veprimit efikas dhe zhvillimit të Shoqatës nacionale, si dhe nëpërmjet dhënies dhe pranimit të ndihmave humanitare.

Neni 59

Organizatat komunale dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit mund të realizojnë bashkëpunim për aktivitetet në planin lokal.

Organizatata komunale dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit mund të realizojnë bashkëpunim ndërkombëtar pas një pëlqimi paraprak të marrë nga Zyra qendrore e Kryqit të kuq të RM-së dhe për këtë është informuar edhe Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së.

KAPITULLI IX

TRANSPARENCA NË PUNË

Neni 60

Puna e Kryqit të kuq të RM-së është transparente.

Shoqata nacionale rregullisht e njofton publikun për punën e saj dhe publikon materiale promovimi për disimilimin e aktiviteteve të saja.

Kryqi i kuq i RM-së njoftimin e publikut e kryen nëpërmjet sistemit të vendosur të informimit të brendshëm dhe të jashtëm nëpërmjet revistës së vet, buletin, broshurat, ueb-faqja zyrtare, rrjetat sociale, ndërsa me mediat e shkruara dhe elektronike komunikon përmes konferencave të shtypit, brifingjet komunikatat dhe në mënyra të tjera të informimit publik.

Me transparencën në punën e tyre anëtarët e organeve dhe trupave të Kryqit të kuq të RM-së kontribuojnë për forcimin e autoritetit dhe afirmimin e tij.

KAPITULLI X

DHËNIA E MIRËNJOHJEVE

Neni 61

Për rezultatet e arritura dhe kontributin e veçantë në zhvillimin e Shoqatës nacionale dhe realizimin e qëllimit dhe detyrës së tij, misionit dhe parimet themelore të individëve, organizatave, institucioneve dhe kompanive jepen mirënjohje përkatëse, tituj etj.

Mënyrat dhe kriteret e dhënies së mirënjohjeve janë rregulluar me akt të veçantë.

KAPITULLI XI

FINANCIMI I KRYQIT TË KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

FINANCIMI

Neni 62

Kryqi i kuq i RM-së mjetet financiare i siguron nga :

1. Pagesa e anëtarësimit e anëtarëve të tij;
2. Buxheti i RM-së për aktivitetet programore të fushës së mbrojtjes preventive shëndetësore, veprimtarisë sociale-humanitare, dhurimit të gjakut dhe për reagimin dhe veprimin në katastrofa;
3. Buxheti i RM-së, buxhetet e njërive të vetëqeverisjes lokale dhe buxheti i qytetit të Shkupit, për Shërbimin për kërkesa- Rivendosjen e lidhjeve familjare dhe pjesëmarrjen në përgatitjet dhe aktivitetet për intervenimin në rast të gjendjeve emergjente, fatkeqësive masive natyrore dhe fatkeqësive në vend dhe jashtë vendit, si dhe për aktivitetet e programit me interes për komunitetin;
4. Veprimtaritë e shërbimit të lidhura me funksionin e Kryqit të kuq të RM-së;
5. Veprimtaritë ekonomike, të ardhurat e të cilave janë përdorur për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të Kryqit të kuq të RM-së;
6. Aktivitetet për mobilizimin e fondeve;
7. Lojërat e fatit në përputhje me dispozitat ligjore;
8. Kompensimet në përputhje me Ligjin e Kryqit të kuq të RM-së;;
9. Të ardhurat nga investimet, kamatat e fondeve të depozituara dhe qiraja;
10. Dhuratat, lënia e trashëgimisë dhe donacionet;
11. Projektet dhe burimet tjera;

Të ardhurat që i fiton Kryqi i kuq i RM-së janë në dispozicion të Kryqit të kuq të RM-së.

KONTRIBUTET FINANCIARE

Neni 63

Çdo organizatë komunale paguan në Kryqin e kuq të RM-së një kontribut financiar vjetor në përputhje me vendimin e Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së.

Organizata komunale që nuk mund të paguajë kontributin financiar vjetor për shkak të arsyeve të caktuara, mund t'i drejtohet Këshillit udhëheqës me qëllim që të përcaktohet një kornizë e caktuar me të cilën organizata komunale do të mund të

paguajë në përputhje me kushtet e përcaktuara në vendimin e Këshillit udhëheqës të Kryqit të kuq të RM-së.

PLANI FINANCIAR – BUXHETI

Neni 64

Viti financiar në punën e Kryqit të kuq të RM-së zgjat nga 01 janari deri më 31 dhjetor.

Plani financiar–buxheti i Kryqit të kuq të RM-së prezantohet nga sekretari i përgjithshëm para Këshillit udhëheqës dhe Kuvendit të Kryqit të kuq të RM-së.

Raportin financiar për llogaritë e lidhura me vitin e mëparshëm financiar, sekretari i përgjithshëm ia dorëzon Këshillit udhëheqës dhe Kuvendit të Kryqit të kuq të RM- së.

FONDET

Neni 65

Kryqi i kuq i RM-së mund të krijojë dhe menaxhojë fonde për aktivitetet e veta, dhe mobilizon fonde për përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe mëvetësisë financiare.

Neni 66

Fondi i solidaritetit i Kryqit të kuq të RM-së punon me llogari të veçantë bankare dhe mjetet e tij financiare janë dedikuar për lehtësimin dhe përmirësimin e jetës së kategorive të rrezikuara të njerëzve.

Neni 67

Fondi për reagim urgjent në katastrofa i Kryqit të kuq të RM-së punon me llogari të veçantë bankare, mjetet e të cilit do të dedikohen për ndihmën dhe mbështetjen e popullsisë së prekur në vend dhe jashtë vendit.

Neni 68

Fondi i zhvillimit i Kryqit të kuq të RM-së punon me llogari të veçantë bankare, mjetet e të cilit do të dedikohen për programet dhe projektet zhvillimore të organizatave komunale dhe të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

Neni 69

Kushtet e funksionimit dhe financimit të fondeve janë rregulluar me akt të veçantë.

VERIFIKIMI DHE MENAXHIMI I RREZIQEVE DHE I REVIZIONIMIT

Neni 70

Kryqi i kuq i RM-së verifikon dhe menaxhon rreziqet dhe ndërmerr masa dhe aktivitete për uljen e rreziqeve dhe pasojave të dëmshme.

Për arsye të një sistemi të qartë dhe transparent të përgjegjësisë në punën financiare të Kryqit të kuq të RM-së është paraparë një sistem i kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm financiar.

Pas përfundimit të çdo viti financiar, llogaritë e atij viti janë subjekt i revizionimit nga një shtëpi e autorizuar, e pavarur e revizionimit.

Kryqi i kuq i RM-së zbaton revizione të aktiviteteve të projektit me kërkesë të donatorit.

Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së organizon një sistem të kontrollit të brendshëm të punës materiale dhe financiare, i cili është rregulluar me akt të veçantë.

PËRGJEGJËSIA

Neni 71

Në Kryqin e kuq të RM-së ekziston një sistem efikas i mbikëqyrjes dhe monitorimit dhe në rast të një cenimi të integritetit të Kryqit të kuq të RM-së, duke përfshirë mbrojtjen e emblemës, përdorimin e mjeteve dhe resurseve për qëllime politike apo personale, diskriminimin, shpërndarjen e parregullt të mjeteve financiare dhe materiale të siguruara nga ana e donatorëve.

Në rast të shkeljeve të konstatuara nga paragrafi 1 i këtij neni do të marrë masa, duke përfshirë heqjen e kompetencave të caktuara të transferuara nga Kryqi i Kuq i RM-së, duke kufizuar përkrahje financiare të caktuar, shpërbërjes së Kuvendit të Organizatës komunale / Kryqit të Kuq të Shkupit, kufizimin e të drejtës për të përdorur emrin dhe emblemën e Kryqit të Kuq dhe ndërprerjen e punës të organizatës komunale / Kryqit të Kuq të Shkupit, si pjesë e Kryqit të Kuq me anë të heqjes së të drejtës për të përdorur emrin dhe emblemën e Kryqit të Kuq.

Për mosrespektimin e akteve të miratuara nga Kuvendi dhe Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së, organizatave komunale dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit u ndërpritet e drejta për përdorim të emrit dhe emblemën.

Neni 72

Kryqi i kuq i RM-së, organizatat komunale dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit përgjigjen për detyrat e tyre me gjithë pasurinë dhe mjetet e tyre.

Anëtarët e organeve të Kryqit të kuq të RM-së, organizatat komunale dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, i menaxhojnë mjetet e Kryqit të kuq dhe i përdorin për realizimin e qëllimeve të Shoqatës nacionale dhe përgjigjen për keqpërdorim të mjeteve për arritje të qëllimeve që për ta si individë janë të ndaluara, për konflikt të interesit, ndërsa anëtarët e organeve që kanë votuar për marrjen e vendimeve dhe bashkërisht përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga moskujdesi i madh apo me qëllim për tu shkaktuar dëm palëve të treta apo Shoqatës nacionale.

Neni 73

Organizatat komunale dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit që kanë vështirësi në realizimin e funksioneve themelore dhe marrin mjete financiare për punën e tyre nga Kryqi i kuq i RM-së, janë të obliguara për dorëzimin e raportit për mënyrën e shpenzimit të atyre mjeteve, si dhe të marrin pëlqim paraprak nga sekretari i përgjithshëm para verifikimit të planit financiar nga Këshilli udhëheqës i organizatave komunale dhe i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

Neni 74

Përcaktimi i përgjegjësisë së organizatave komunale dhe i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, si dhe i anëtarëve të organeve udhëheqëse në organizatën e Kryqit të kuq është rregulluar me akt të veçantë.

PASURIA

Neni 75

Kryqi i kuq i RM-së ka të drejtë për të fituar pasuri të tundshme dhe të patundshme, si dhe të drejtat që ka udhëheq me to

Kryqi i kuq i RM-së ka të drejtë për të pranuar pronë, kontribute të pakufizuara dhe ndihma nga shoqatat tjera nacionale, individë, qeveri dhe subjekte të tjera publike apo private.

Kryqi i kuq i RM-së mund të pranojë mjete në të holla, donacione, trashëgimi dhe prona për përdorim apo dobi të veten në qoftë se është në përputhje me ligjin, gamën e aktiviteteve, qëllimin e përgjithshëm dhe funksionet dhe nuk rrjedhin nga aktivitetet që janë në kundërshtim me Parimet themelore apo me qëllimet e Shoqatës nacionale.

Në rast të ndërprerjes së punës, prona e organizatave komunale dhe e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit kalon në pronësinë dhe të drejtën e shfrytëzimit të Kryqit të kuq të RM-së.

Kapitulli XII

NDËRPRERJA E PUNËS SË KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Neni 76

Kryqi i kuq i RM-së ndërpret punën kur paraqiten kushtet e parashikuara nga ligji dhe kur Kuvendi merr vendim për ndërprerjen e punës së Kryqit të kuq të RM-së, me shumicën 2/3 (dy të tretat) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote.

Me ndërprerjen e punës së Kryqit të kuq ndërpritet edhe veprimtaria e Organizatës komunale / Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit

Ndërprerja e punës së Kryqit të kuq të RM-së, çështja e pasurisë dhe detyrimet zgjidhen në përputhje me këtë Statut, dispozitat ligjore dhe rregulloret ekzistuese.

Pjesa tjetër e mjeteve financiare jepen vetëm për qëllime humanitare të dedikuara për të mirën e përgjithshme

Materialet arkivore të Kryqit të kuq të RM-së për shkak të rëndësisë së tyre në tërësi do t'i dorëzohen Arkivit të Republikës së Maqedonisë, Shkup, apo të trashëgimitarit juridik të institucionit të lartpërmendur, në mënyrën që është në përputhje me dispozitat ekzistuese ligjore për punën arkivore dhe arkivimin

KAPITULLI XIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 77

Statuti i Kryqit të kuq të RM-së miratohet nga Kuvendi i Kryqit të kuq të RM-së me shumicën 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve të pranishëm në Kuvend me të drejtë vote.

Hartimin dhe Propozimin e Statutit e përcakton Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së.

Ndryshimet dhe plotësimet e dispozitave të Statutit kryhen në mënyrën dhe procedurën si për miratimin e tij.

Për miratimin e Statutit të ri, si dhe për ndryshimin dhe plotësimin e tij, nevojitet rishikim dhe pëlqim paraprak i Komisionit të përbashkët të Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Komitetit ndërkombëtar i

Kryqit të kuq për Statutet e shoqatave nacionale, dhe në përputhje me Konferencën e 22-të ndërkombëtare e mbajtur në Teheran në vitin 1973 dhe Rezoluta 6 e saj.

Neni 78

Aktet që dalin nga ky statut të miratohen dhe harmonizohen me Statutin më së voni në afat prej 6 (gjashtë) muajsh nga dita e miratimit të tij.

Neni 79

Organizatat komunale të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit janë të obliguara të harmonizojnë statutet e tyre me këtë statut në afat prej 2 muajve nga dita e miratimit të këtij Statuti.

Ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave të statuteve të organizatave komunale dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit kryhet në mënyrën dhe procedurën si për miratimin e tij. Për miratimin e një Statuti të ri, si dhe për ndryshimin dhe plotësimin e tij nevojitet pëlqim paraprak nga Komisioni për statutin dhe aktet normative të Kryqit të kuq të RM-së.

Neni 80

Statuti hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Neni 81

Miratimi i këtij statuti shfuqizon Statutin e Kryqit të kuq të RM-së nr.03-900 të vitit 26.12.2003 dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij të viteve 2006, 2012, 2013 dhe 2015.

Kryetar,
Dr. Millço Trajkov

Komisioni i përbashkët i Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq për statutet e shoqatave nacionale konfirmuan se ky statut është në përputhje me normat minimale të përcaktuara në Udhëzimin për përgatitjen e statuteve të shoqatave nacionale, vërtetuar nga Kryqi i kuq i RM-së me numrin 0101-5/3 të datës 22.02.2017.

